

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nga 38 mijë euro të dhëna në 123 mijë të paguara: çfarë thuhet në dosjen për tre të dyshuarit për fajde
ADRESA	https://albeu.com/kosove/nga-38-mije-euro-te-dhena-ne-123-mije-te-paguara-cfare-thuhet-n-e-dosjen-per-tre-te-dyshuarit-per-fajde/1028850/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 18:53:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 18:48:48 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	47a87d26b31896468393d919f19618ed387ab44c0b770bf2dcf31461841591b6
TEKSTI	2e4ac45f89f4063b98b57b333a6bf8a9d96c7ff6c2d73b72dd8d5ece5e5df5bf
PAMJA	20490b6137984a2c34a384e93cb0e0c5bedcbf8fd0b5b52ee6e7e9743f5d6ea6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b7fafdd1429feceaec2d02da95c9f9add4669026c8f07ebbaa56bc7494791b4d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	bdb0f4977024bde548b4e3b2f30b00cf48adba46ab69ac7a79901c9e1751e8c0
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b7fafdd1429feceaec2d02da95c9f9add4669026c8f07ebbaa56bc7494791b4d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Nga 38 mijë euro të dhëna në 123 mijë të paguara: çfarë thuhet në dosjen për tre të dyshuarit për fajde



Një person që dyshohet se mori 38 mijë euro hua, përfundimisht u detyrua të paguante 123 mijë euro, sipas pretendimeve të Prokurorisë. Dosja e siguruar nga media përmban edhe prova të mbledhura lidhur me rastin.

Tre persona, B.M, Sh.B dhe M.B, u arrestuan nga Policia e Kosovës të mërkurën, më 23 shtator, nën dyshimin për veprat penale "Fajde" dhe "Kanosje". Tëvë1 ka siguruar dosjen e Prokurorisë Themelore të Prishtinës, e cila ka kërkuar caktimin e paraburgimit për të dyshuarit.

Sipas Prokurorisë, të arrestuarit i kanë dhënë A.Y.-së gjithsej 38 mijë euro, duke përfutur nga vështirësitë e tij financiare. Marrëveshja, pretendohet, parashihte kamatë mujore prej 10 për qind dhe kishte nisur në vitin 2021.

Prokuroria thotë se A.Y. nuk kishte mundësi t'i kthente paratë me kamatë dhe se B.M e telefononte vazhdimisht, duke i thënë se ishte nën presionin e Sh.B. Deri në maj të vitit 2026, i dëmtuari dyshohet se ishte detyruar të paguante 123 mijë euro. Më 11.09.2026, në një takim mes B.M dhe M.B, atij iu kërkuar edhe 27 mijë euro të tjera.

M.B dyshohet gjithashtu se e ka kërcënuar në mënyra të ndryshme një nga viktimat. Sipas dosjes, në maj të vitit 2026 ai komunikoi edhe me djalë e A.Y.-së, duke i shkaktuar ankth dhe shqetësim. Përmes SMS-ve, pretendon Prokuroria, M.B ushtronte presion të vazhdueshëm për kthimin e parave dhe e paralajmëroi se, nëse borxhi nuk paguhej, "do të bëhet shumë keq".

Organi i akuzës e konsideron të domosdoshëm paraburgimin, pasi të dyshuarit në liri mund të ndikojnë te dëshmitarët. Gjykata Themelore e Prishtinës vendosi gjatë ditës që ndaj të treve të caktohet kjo masë.

Televizioni ka siguruar edhe deklaratën që M.B dha në Policinë e Kosovës. Ai pranoi se i kishte dhënë para A.Y.-

të fundit /



Nga 38 mijë euro të dhëna në 123 mijë të paguara: çfarë thuhet...



Mbyllen hetimet për vrasjen e gjyqtarit Astrit Kalaja, prokuroria i...



Irlanda jep dritën jeshile për përbaljen me Izraelin pas votimit të...



Nisin pagesat për viktimat e rastit të komandantit "Cali



Protesta kundër vendimit të Hagës, qytetarët nisin tubimi...



Presidenti Duka: Maran është zgjedhja e duhur, nisja me fitore do t'i...



Trump i jep botës "goditjen" e papritur, refuzon hapjen e...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

së, por mohoi se këtë e kishte bërë për fajde.

M.B deklaroi se nga viti 2021 deri në vitin 2023, aq sa i kujtohej, i kishte dhënë A.Y.-së gjithsej 52 mijë euro, në shuma dhe kohë të ndryshme. Ai tha se paratë nuk ishin të tijat, por i kishte marrë nga daja që jeton në Austri, si dhe kishte marrë kredi dy herë nga 2 mijë euro dhe një herë 5 mijë euro.

I pyetur nëse i kishte dhënë A.Y.-së para me interes fajde, M.B u përgjigj: “Jo, kurrë në jetë”.

Ai tregoi se për këtë borxh kishte marrë para edhe nga familjarët e A.Y.-së, përfshirë bashkëshorten, djalin dhe vajzën. Sipas deklaratës së tij, në vitin 2023 ata i dhanë afërsisht 52 mijë euro në shuma dhe kohë të ndryshme. M.B tha se bashkëshortja nuk e dinte që A.Y. kishte borxh ndaj tre personave nga Shqipëria dhe se këtë e dinte vetëm A.Y. Ky i fundit, sipas tij, i kishte kërkuar t'i thoshte bashkëshortes se paratë ishin për disa persona nga Peja.

Gjatë kontrolleve në banesat e të dyshuarve, policia sekuestroi telefona, 20 dosje të ndryshme për shitblerje, një fletore me shënime, para në euro dhe franga, si dhe një veturë Audi A6.

Shtuar më 26.09.2026 20:48

Tags: arrestimi , fajde , kosova , Persona



Jo në emrin tim", qytetarët mblidhen për të 11-ën natë në mbështetje të UÇK-së...




Nisin pagesat për viktimat e rastit të komandantit "Cali"



Protesta kundër vendimit të Hagës, qytetarët nisin tubimin në Prishtinë



Instituti GAP: Mbi 250 mijë kosovarë u pajisën me leje qëndrimi në BE nga viti...




Kurti: Votimi i vitit 1991 konfirmoi synimin për pavarësi



Ekspertët vlerësojnë ndikimin e mundshëm të një baze të përhershme...



Behrami: Specialja i paraqet viktimat e pretenduara të UÇK-së si...



Albin Kurti pezullon drejtorin Hysen Muzliukaj pas aktakuzës për...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.